



Npi – 01/162 datë: 02.05.2025

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 02.05.2025, është nxjerrë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I Mbledhjes së -IV- të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
e mbajtur më datën 02.05.2025 (e premte), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Gëzim Haxhiu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Rexhep Gashi dhe z.Reshat Mujota.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu; Të gjithë drejtorët e drejtorive komunale; Nga OSBE-ja z.Mefail Mustafa; Shefja e Kabinetit të Kryetarit, znj.Anita Kurti; Nga zyra për të drejtat e Njeriut dhe Barazi gjinore, z.Reshat Gashi; Nga Zyra për Informim, znj.Vlora Hyseni; Asistentja e Kryesuesit znj.Gentiana Mehmeti; Zyrtarë i IT-së, z.Shpëtim Gashi, nga Radio Zëri i Shtimes z.Muhamet Hoxha.

Për këtë seancë kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 03.04.2025,
2. Raporti Tremujor Buxhetor Janar-Mars 2025,
3. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit Paraprak për dhënien në shfrytzim pronat Komunale në Z.K-Shtime, Npi-01/25 dt.27.01.2025, sipas rekomandimit të MAPL - Nr.020-54/8-2025 dt.26.02.2025,
4. Propozim-Vendim për formimin e Komisionit të Aksionarëve për ndërrmarrjen Publike Lokale “Ekosistemi” SH.A – Shtime,
5. Draft-Plani i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027, (Për diskutim publik)
6. Propozim-Vendim për Plotësimin e Komitetit për Komunitete,
7. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve nga Kuvendi të Komisionit për ndarjen e bursave për student 2024/25,
8. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Reshat Mujota: Përshëndetje. Sa i përket rendit të ditës unë pajtoj. Kamë vërejtje për kohën që mbledhjen po e fillojmë me 21 minuta vonesë. Sot jemi thirrë edhe për një mbledhje të jashtëzakonshme, unë po kërkoj një sçarim pse jemi thirrë për mbledhje të jashtëzakonshme kur kemi mundësi me mbajtë mbledhje të rregullt.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Tani këtu jemi në mbledhjen e rregullt, sçarimet për këtë pjesë I japim në mbledhjen e Jashtëzakonshme.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Vërejtja e parafolsit është me vend, sepse ju po vonoheni dhe çdo here po ndodhë e njehta. Sa i përket pikave unë propozoj që pika e 8 (Pyetje-përgjigje) me dale e para sepse kohën po e humbni ju vetë.

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje. Ne e përkrahim rendin e dsitës ashtu qysh na ka ardhur me ftesën për mbledhje të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje. Kryesuesi i dëgjova parafolësit për mbledhjen e jashtëzakonshme. Për mbledhjen e katërt ka ardhë materiali, por Planin e punës je kah e ndryshon, je keq me numra dhe po e shtynë mbledhjen, ku e din ti që ne e kryjmë mbledhjen e rregullt deri në ora katër, kur edhe e ke thirrë mbledhjen e jashtëzakonshme.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Thash për mbledhjen e jashtëzakonshme do flasim kur të jemi në mbledhje. Në vazhdim Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për”, me 8 vota “Kundër”, dhe me 2 vota “Abstenim”, miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 03.04.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rexhep Gashi: Nuk janë përfshi disa diskutime të mija në procesverbal. Unë kamë thënë nuk më ka ardhur materiali me kohë, dhe jo i kompletuar, prandaj kërkoj përmirësimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për”, me 0 vota “Kundër”, dhe me 8 vota “Abstenim”, miratoi Ekstrakt procesverbalin nga mbledhja e kaluar më 03.4.2025.**

Pika 2

Raporti Tremujor Buxhetor Janar-Mars 2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Më lejoni që para jush të prezantoj Raportin tremujor Buxhetor Janar-Mars 2025, duke u bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 45.4 të Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësitë. Materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, prandaj unë do të ndalem vetëm te pikat kryesore të raportit të ndarjet sipas buxhetit të kategoritë ekonomike. Buxheti për këtë vit ishte 10.778.000€. Në vazhdim lexoi raportin në pikat kryesore. (Shih dokumentin) Ju ftoj që ta miratoni këtë raport, nëse ka ndonjë pyetje jamë i gatshëm të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa: Sa i përket raportit, shumicën e përgjigjeve i kamë marrë në KPF-ë. Pyetje kamë unë për shetitjen në Budvë dhe Kotor, nëse ke mundësi me na tregu se ka sa birra i kanë pi edhe ka sa karkaleca i kanë ngrënë, a ka hy kjo shetitje e juaja në këtë raport.

znj.Adelina Beqaj: Faleminderit për raportin. Po më intereson vlera e përqindjes të tatimit në pronë në këtë periudhë sa ka qenë. Pyetje, qysh është e mundur që në DKA e keni 0 përqindjen sa i përket shpenzimeve. Pastaj të huamarrja nuk keni shpenzuar asgjë. Nga mbledhja e KPF-së për në Kuvend kamë pritë që ke me na dhënë Shifra konkrete.

z.Muhamet Ademaj: Faleminderit për raportin 3 mujor i cili është shpenzuar mjaftë mirë dhe me një përqindje mjaftë të mire prej 22.6 %. Ne si grup parlamentar LDK-AKR e mbështesim këtë raport dhe do ta votojmë.

z.Rexhep Gashi: Faleminderit drejtor për elaborimin. Propozimi për të hyrat e bartura nga 2024 në 2025, qysh figuron një sçarim për këtë.

znj.Sanije Sadiku: Përshëndetje. Me raport jemi në rregull, veç diçka desha me e pyet opozitën, se a keni qenë ju najherë në ekskurzion?

z.Përparim Ramusa: Unë kamë qenë dy mandate në Kuvend, por ne nuk kemi qenë asnjëherë për trajnime. Sa e di unë me këtë Kryesues kemi qenë një here në Vlorë për me mbajtë mbledhje.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Faleminderit për pyetjet. Trajnimet kanë ndodhur në tremujorin e dytë, dhe për to do të raportojmë kur vjen koha për me raportu për raportin 6 mujor. Te pyetja për shpenzimet në DKA ju lutem gjeni faqen 12 të raportit te pikat 13-16 dhe aty mund ti shihni shpenzimet që janë bërë në DKA. Sa i përket huamarrjes, ka përfunduar në vitin e kaluar për këtë arsye këtu nuk ka shpenzim. Sa i përket shpenzimeve te të hyrat, ne normalisht që përparësi i japim shpenzimeve nga grantet, sepse siç e dini të hyrat mundemi me i shpenzu por edhe nëse mbesin pa u shpenzu ato mund të barten në vitin tjetër.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për”, me 8 vota “Kundër”, dhe me 0 vota “Abstënim”, miratoi Raportin Tremujor Buxhetor të Komunës së Shtimes për Janar-Mars 2025.**

Pika 3

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit Paraprak për dhënien në shfrytëzim pronat Komunale në Z.K-Shtime, Npi-01/25 dt.27.01.2025, sipas rekomandimit të MAPL - Nr.020-54/8-2025 dt.26.02.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Kjo pikë ka kaluar në KPF-ë. Nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e kemi pranuar një rekomandim që kjo pikë duhet të rishqyrtohet edhe një here nga Kuvendi, për arsye se njëra pronë nuk ka qenë në listën e pronave që mund të epet në shfrytëzim afatgjatë, për këtë arsye tani ne duhet që këtë vendim ta ndryshojmë dhe në vendim të mbetet vetëm prona që është në listë. Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj: Edhe unë kamë të bëj me ekonominë, dhe drejtori është i obliguar me dhënë përgjigje sepse paguhet për këtë.

z.Asllan Beqaj: Përshëndetje. Nje sygjërim për ty Adelina, mos u merr me të tjerët por me punët e tua. E kur e merr fjalën me folë për pozitën kujdes se qka po folë sepse ne e dime se qka votojmë, për arsye se pak më pare e thae se këta nuk e dine as për çka votojnë.

z.Lumni Amrushi: Përshëndetje. Ju lutem mos me u lëshu në personale, sepse po del nga kontrolli, mirëpo ne jemi mësuar me ju që i sulmoni edhe grate shtatzëna. Po kthehen pikat e rendit të ditës edhe pse e kemi votuar me 3-4 herë vendimin. Këtë pronë e keni propozu me futë në vendim pa qenë fare në listen e pronave që mundet me u dhanë në shfrytëzim. E kemi edhe një mbledhje në ora 16 kështu që duhet ta mbajmë një pauzë deri në ora 13 e pastaj të vazhdojmë.

z.Reshat Mujota: Për këtë vendim që e kemi marrë më datën 27.1.2025 e lexova edhe rekomandimin e MAPL-së për ndarjen e parcelës, mirëpo tash me u nda kjo parcelë qysh po kërkohet a i plotëson kriteret për sa i përket sasisë së sipërfaqes? Dhe parcela tjetër që po mbetet a do të shpallet edhe ajo apo për çka do të përdoret? Edhe për vendimin për ndarjen e parcelës për ndërtimin e Xhamisë në Shtime e kërkohet një përgjigje çka ka ndodhur me atë vendim?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Siç e dini ne kemi marrë një vendim për investime në fushën e energjisë me panele solare, aty kanë qenë të përfshira dy parcela, njëra ka qenë në listen e pronave komunale që mund të ipen në shfrytëzim e njëra jo për arsye që i kanë dhënë drejtorja e urbanizmit, tash për me mujtë me dhanë edhe këtë prone në shfrytëzim, fillimisht duhet me futë në listen e pronave që mund të ipen në shfrytëzim. Rekomandimin e kemi nga MAPLJ-ja që mund të vazhdojmë me njërën pronë. Dhe tani ne këtë po e bëjmë. Për sa i përket pronës për ndërtimin e Xhamisë, kanë kërkuar informata shtesë, dhe tani është në shqyrtim te ministria e linjës, mirëpo ende nuk kemi një përgjigje definitive.

z.Përparim Ramusa: Po flas në emër të grupit parlamentar të PDK-së. Marramendje duhet me pas ju kur e ofendoni një femër. E sa i përket kësaj pike duhet me pas edhe ju kokëdhimbje. Në

emër të grupit ne jemi që të korigjohet ky vendim, por mos bëni këso gabimesh sepse i keni 10 jurista në Komunë, që sillen koridoreve.

znj.Zejnije Veliu: Përshëndetje: Ofendime kemi pas nga ju PDK-ja, shumë e sidomos unë personalisht kamë pas, por të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

z.Reshat Mujota: Nuk ma dhae përgjigjen e drejtë, sepse Ministria e ka kthyer këtë vendim të kundërligjshëm, mund ta bëj publik këtë vendim të Ministris nëse doni. Kërkoj që zyrtari Ligjor me marrë pjesë në mbledhje të Kuvendit. Unë jamë që të kalojë ky vendim sipas rekomandimit të MAPL-së.

z.Rexhep Gashi: Është dokument i rëndësishëm, një vendim që e kemi marrë të kundërligjshëm dhe MAPL-ja e ka kthyer në rishqyrtim kjo ka ndodhur për shkak të pa aftësisë së juaj e që ka qenë për fushën e sportit e ju e keni dhënë për Panelet Solare.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve prezent në seancë.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 16 vota “Për”, me 0 vota “Kundër”, dhe me 3 vota “Abstënim”, miratoi Vendimin Paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale në Zonën Kadastrale Shtime, Ngastra Kadastrale me numër: P-72809093-01403-0, me sipërfaqe prej: 140629m², Kultura - Kullosë e klasit të -IV- (katër). Z.K-Shtime. Pronari/Poseduesi “Komuna e Shtimes”.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pauzë 5 minuta kanë kërkuar grupi parlamentar LDK-AKR për konsultime në ora 11:25h. Kthehemi në ora 11:30h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Vazhdojmë me mbledhjen në ora 11:30h. kemi mbetur te pika e 4.

Pika 4

Propozim-Vendim për formimin e Komisionit të Aksionarëve për ndërrmarrjen Publike Lokale “Ekosistemi” SH.A – Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Kjo pikë ka kaluar në KPF-ë. Tani jemi në fazën e formimit të Komisionit të Aksionarëve për ndërrmarrjen publike lokale “Ekosistemi” SH.A. e cila është në formim e sipër. Për ta formuar këtë Komision Kuvendi duhet ti zgjedhë dy anëtarë të Komisionit, dhe një anëtarë e emëron Kryetari i Komunës. Ju ftoj që ti propozoni emrat e dy anëtarëve të këtijë Komisioni.

z.Muhamet Ademaj: Unë në emër të grupit parlamentar LDK-AKR e propozoj z.Kadri Emini.

znj.Saniye Sadiku: Unë në emër të grupit parlamentar të LVV-së e propozoj z.Asllan Beqaj.

z.Reshat Mujota: Unë propozim nuk kamë, por e uroj Kadriun. Kamë një pyetje konkrete rreth kësaj, a është bërë ndonjë studim i fizibilitetit, sepse ne nuk kemi njohuri fare për këtë ndërrmarrje, edhe pse unë do ta votoj formimin e Komisionit. Zgjedhni njerëz që punojnë. Komisioni i Aksionarëve për ndërrmarrjen publike të “Pastërtisë” a ka funksionuar?

z.Kadri Emini: Përshëndetje. Fillimisht unë e uroj Frosina Berisha-Ahmeti në detyrën e Drejtorit për Zhvillim Ekonomik, i uroj suksese në punën e sajë. Sa i përket deklarimit të Reshat Mujotës që për 5 minuta pauzë që i kërkuam ai i quan pazare. Këto konsulta janë të ligjshme, sepse unë konsideroj se me dhënë propozime pa u konsultuar fare paraprakisht është pa përgjegjësi totale. Reshata e dinë këtë punë mire, por këtë e thot vetëm për arsye politike. Deklaroj se e pranoj kandidaturën për me marrë këtë përgjegjësi, dhe kërkoj votën e anëtarëve të Kuvendit.

z.Reshat Mujota: Unë thash në fillim se kamë me e votu Komisionin. Unë ua them haptazi në sy se ju bashkëpunoni herë me pozitën e herë me opozitën për ti arritur pazaret e juaja.

z.Kadri Emini: Nuk qëndrojnë këto që u thanë, sepse le të del dikush këtu dhe ta përmend një rast të vetëm. Ç’do diskutim jashtë pikave të rendit të ditës është shkelje e besimit të votuesve.

z.Përparim Ramusa: Frosinës i uroj pozitën e drejtorit për zhvillim ekonomik. Mirë do ishte që me e prezantuar Kryetari, mirëpo po shihet që nuk e paska zgjedhur Kryetari por LDK-ja. Ju e keni kapë edhe këtë institucion, kështu që unë kamë vërejtje në konceptin e juaj të kapjes së institucioneve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Përparim, të drejten e ke edhe ti për me propozuar.

z.Kadri Emini: Sa i përket zgjedhje së Frosinës drejtoreshë, nuk është e vërtetë ajo që u tha këtu se e ka zgjedhur LDK-ja, por mund të them se Frosina e ka pas mbështetjen time pore dhe të Kastriotit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në seancë.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për”, me 1 votë “Kundër”, dhe me 6 vota “Abstenim”, miratoi, vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërrmarrjen Publike Lokale “Ekosistemi” SH.A. – Shtime, si vijon:**

1. **Asllan Beqaj - Rr. “Beqa” Nr.30 Petrovë (i zgjedhur nga Kuvendi)**
2. **Kadri Emini - Rr. “ Emini” Nr.28 (i zgjedhur nga Kuvendi)**
3. **Idajet Rexhepi - Rr. “Dëshmorët e Godancit” Nr.200, (i emëruar nga Kryetari i Komunës)**

Pika 5

Draft-Plani i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027, (Për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën ja dha znj.Albana Podvorica.

znj.Albana Podvorica: Përshëndetje. Ky Draft-Plan për punën e ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025-2027 duhet të shkojë në diskutim publik, dhe në kuadër të kësaj unë uroj që të ketë në diskutim një gjithpërfshirje sa më të madhe, sepse është një dokument i rëndësishëm për të drejtat e fëmijëve. Ju ftoj që ta votoni.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Unë uroj që ky dokument të kalon në diskutim publik dhe të miratohet, si dhe të gjej zbatim në praktikë. Ne në Komitetin për Komunitete e kemi diskutuar këtë pike dhe i kemi rekomanduar Kuvendit miratimin e këtijë Plani, me vërejtjen që në ekip të përfshihet edhe zyrtari i zyrës për komunitete dhe kthim z.Muhamet Mehmeti.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve prezent në seancë.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Planin e Punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve për periudhën 2025 – 2027. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra e Kryetarit në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 6

Propozim-Vendim për Plotësimin e Komitetit për Komunitete

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Në Komitetin për Komunitete i kemi tri dorëheqje nga ky Komitet për arsye të tyre personale. Tani ne si Kuvend duhet që ti plotësojmë këto tri pozita të anëtarëve të KPK-së. Dorëheqje kanë dhënë: Shkurte Behluli, Muhamet Mehmeti dhe Shkurte Mustafa.

znj.Saniye Sadiku: Ne e propozojmë Artan Lubovcin.

znj.Adelina Beqaj: Ne propozojmë që në vend të Shkurte Mustafës të vjen një femër, kështu që unë e propozoj Besartë Musliu-Spahija.

z.Reshat Mujota: Këta që kanë dhënë dorëheqje a janë propozuar, urime e këta që po vijnë suksese. Unë kam qenë kundër për mos me i formu Komitetet jo-obligative. LVV-ja e ka një përfaqësues në këtë Komitet, Besnik Seferin. Nëse ka përparësi subjekti unë e kisha propozuar Gëzim Haxhiun, për me ja ngjitë dorën, pak kështu që Gëzimit edhe unë ja kisha dhanë votën.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Duhet ta dime faktin se ne sot nuk po themelojmë Komitet, por po e plotësojmë atë me anëtarët që kanë dhënë dorëheqje. Komitetet i kanë propozuar anëtarët e tyre e LVV-ja e jep propozimin e vetë për anëtarin që ka dhënë dorëheqje Shkurte Mustafa. Nëse po flasim për kuotën gjinore ajo është e plotësuar.

z.Rrahman Jakupi: Lexoi nenin 51 të LVV-së, Komiteti reflekton përbërjen e subjekteve politike të Kuvendit. PDK-ja nuk e ka pas një anëtarë, dhe ky vendim do të kthehet si i kundërligjshëm, sepse nuk reflekton përbërjen e Kuvendit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ky pra është vendim për plotësimin e Komitetit për Komunitete për anëtarët që kanë dhënë dorëheqje nga ky Komitet vullnetarisht për arsyet e tyre personale, tani ne duhet ta plotësojmë Komitetin me anëtarë të ri.

z.Reshat Mujota: Ky është në Komitetin për Shëndetësi, prandaj mundet me u kthy i kundërligjshëm, por ndoshta edhe jo sepse Artani me letra është i PDK-së.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Artan Lubovci nuk është zgjedhur në asnjë Komitet.

z.Reshat Mujota: Unë kamë dhënë dorëheqje sepse nuk kamë dashur me bashkëpunuar me atë tjetrin drejtor nga Fushë Kosova. Dhe po ashtu kamë deklaruar se hjeki dorë nga kompenzimi.

z.Besnik Seferi: Në Komitetin për Komunitete, jemi duke e bërë punën bashkërisht. Emrat e ri për plotësimin e Komitetit është mire me i votuar. Është mirë me pas aty edhe ndonjë anëtarë të PDK-së, për me pa se çka po punon. Komiteti për Komunitete mund të themi se tash e ka një gjithpërfshirje, sepse kanë qenë dy nga LVV-ja e tani e kemi edhe një nga AKR-ja.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve prezent në seancë.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për”, me 2 vota “Kundër”, dhe me 6 vota “Abstenim”, zgjodhi z.Artan Lubovcin, anëtarë të Komitetit për Komunitete.**

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për”, me 0 vota “Kundër”, dhe me 6 vota “Abstenim”, zgjodhi znj.Arjeta Maliqin, anëtare të Komitetit për Komunitete.**

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 12 vota “Për”, me 0 vota “Kundër”, dhe me 7 vota “Abstenim”, zgjodhi znj.Sabrije Veliun, anëtare të Komitetit për Komunitete.**

Pika 7

Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve nga Kuvendi të Komisionit për ndarjen e bursave për student 2024/25

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Në këtë pike e kemi propozimin nga DKA-ja për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për student. Propozimin nga PDK-ja e kemi nga Komiteti për Politikë dhe Financa për znj.Albana Podvorica, e cila ka qenë anëtare e këtij Komisioni edhe vitin e kaluar. Po ashtu edhe nga LDK-AKR e kemi propozimin e njejt nga mandate i kaluar i znj.Rrezartë Ramdani. Ndërsa ne si LVV-ë e propozojmë z.Asllan Beqaj. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pike nëse ka dikush me diskutuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në seancë.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për zgjedhjen nga Kuvendi të 2 (dy) anëtarëve të Komisionit për ndarjen e Bursave për Studentë, për vitin akademik 2024/2025, si vijon: z.Asllan Beqaj, (Përfaqësues nga pozita) znj.Albana Podvorica, (Përfaqësuese nga opozita)**

Pika 8

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtyre pikë.

z.Reshat Mujota: Unë propozoj që këtë pikë me lanë për me i bërë pyetjet me ardhë pak para orës 16 kur e kemi edhe mbledhjen e Jashtëzakonshme.

z.Rexhep Gashi: Unë propozoj që të shkojmë në pauzë.

z.Lumni Amrushi: Sot i kemi dy mbledhje, dhe pyetjet mund ti bëjmë në seancën e orës 16:00h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pajtoj me propozimin e Lumni Amrushit, që pyetjet me i parashtruar në seancën e jashtëzakonshme të orës 16:0h.

Pasi që diskutime të tjera nuk ka seancën e mbylli në ora 12.27h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

